



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:084527

Datë: 27.02.2025

Numri i dokumentit: 06916592

P.nr.215/24

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale, kundër të pandehurit A.B, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.281/24 të datës 14.03.2024, pas shqyrtimit fillestar të hapur për publikun, i mbajtur me datë 05.02.2025, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, i dëmtuari S.K, i pandehuri A.B, me datën 07.02.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 27.02.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

**A.B**, i lindur me datë ....., në Pejë, me vendbanim në Pejë, lagjja “.....”, nr....., i atësisë L. dhe amësisë Z., e vajzërisë ....., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon numër tel. ...., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. .... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet në paraburgim për një vepër tjetër penale.**

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se:

Me datën 06.12.2023, në kohë të pa caktuar, në Pejë, pikërisht në Spitalin Regjional-Reperti i Kirurgjisë, me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër dhe atë ndaj të dëmtuarit S.K, në atë mënyrë që pasi zyrtarët e shërbimit korrektues nga Qendra e Paraburgimit e kishin dërguar të dëmtuarin për trajtim mjekësor, me tu futur në dhomën e sigurisë ku gjendej i paraburgosuri tjetër këtu i pandehuri A.B, në prezencën e zyrtarëve policor e godet të dëmtuarin një herë me grusht në gjoks, mirëpo nuk i shkakton lëndime trupore,

- Me çka ka kryer vepër penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, dhe 184 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe neneve 240, 241, 364, 365, 449, 452, 458, 460 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## G J Y K O N

- I. Me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej katër (4) muajsh, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. I pandehuri obligohet që gjykatës ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, dhe shumën prej njëzetë (20) euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. I dëmtuari S.K, nga Peja rruga “.....”, në Pejë, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 14.03.2024 ka ngritur aktakuzë nën shenjen PP/II.nr.281/24, ndaj të pandehurit A.B, për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 05.02.2025, në praninë e Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha, të dëmtuarit S.K si dhe të pandehurit A.B.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurit gjykata i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore konform nenit 241 paragrafi 1 të KPPRK-së, gjykata e ka njoftuar të pandehurin me të drejtën që të përfaqësohet nga një mbrojtës por i njëjti ka deklaruar se nuk ka nevojë të caktojë një mbrojtës dhe se mbrojtjen dëshiron ta jap personalisht, andaj gjykata ka vazhduar seancën duke e ftuar Prokuroren e Shtetit që të lexoj aktakuzën dhe pasi që gjykata është bindur së i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë presioni ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “*Sulmi*” nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç’rast Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i plotëson kushtet, ka*

*mbështetje në prova, dhe i kërkoj gjykatës që të njëjtit t'ia aprovojë, ngjashëm është deklaruar edhe i dëmtuari S.K i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitat ligjore të nenit 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit dhe pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Deklarata e të dëmtuarit S.K e dhënë në stacionin policor në Pejë e datës 07.12.2023; Deklarata e të pandehurit A.B e dhënë në stacionin policor në Pejë e datës 07.12.2023; Raporti i policit K.C e datës 07.12.2023;* ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave rënduese i kërkoj gjykatës që të marr parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndaj të pandehurit ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I dëmtuari S.K, ka deklaruar së: *të pandehurin nuk e njoh personalisht, unë i'a kam falur çfarëdo që ka ndodhur, me të pandehurin nuk kemi pasur me konflikte, e njoh të pandehurin që ka një gjendje të dobët ekonomike, unë i'a kam falur, nuk dëshiroj të parashtoj kërkesë pasurore juridike.*

I pandehuri A.B, ka deklaruar së: *jam penduar për veprën penale që ka ndodhur, ka qenë në ditën e parë ose të dytë, kam qenë nën ankth, jam shumë i penduar, i kërkoj falje të dëmtuarit, i premtoj gjykatës që nuk do të përsërisë vepra penale.*

Prandaj me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Sulmi” nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit shprehimisht në seancë, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer, si rrethana rënduese gjykata mori vendin e kryerjes së veprës penale e që është brenda Spitalit Regjional në Pejë-Reperti i Kirurgjisë e në të cilin i dëmtuari kishte shkuar për trajtim mjekësor, pastaj gjykata ka marrë për bazë të kaluarën kriminale të të pandehurit dhe atë faktin se i njëjti është i dënuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën e P.nr.1168/23 të datës 30.01.2024, cili është bërë i plotfuqishëm me datë 07.05.2024, për veprën penale *“Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 269 par 1 të KPRK-së*, i njëjti është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti si dhe dënim me gjobë në lartësi prej nga pesëqind (500) Euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën provuese prej 2 vitesh, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Pejës-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.454/2021 të datës 27.11.2023, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 28.05.2024, për shkak të veprës penale *“Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope apo analoge” nga neni 269 par.1 të KPRK-së*, i njëjti është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindpesëdhjetë (150) ditësh, si dhe dënim me gjobë në shumën prej dyqindpesëdhjetë (250) euro, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë –Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.375/2018, të datës 25.01.2019, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 15.02.2019, për shkak të veprës penale *“Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 275 par.2 të KPRK-së*, i cili është dënuar me dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) Euro, poashtu sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.121/2018, të dt.24.05.2024, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 30.07.2024, për shkak të veprës penale *“Lëndim i lehtë trupor” nga neni 188 par. 2 të KPRK-së*, dhe veprën penale *“Asgjësim apo dëmtim i pasurisë” nga neni 333 par.1 të KPRK-së*, ku të njëjtit i është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej gjashtëmbëdhjetë (16) muajsh, i cili dënim kushtëzohet, nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, nga çka rezulton se pavarësisht dënimeve të mëparshëm sjelljet e tij nuk kanë ndryshuar në drejtim të përmirësimit dhe dënimet nuk e kanë arritur qëllimin e tij e që është pengimi që në të ardhmen i pandehuri të mos përsërisë vepra të tjera penale

Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se edhe me këtë dënim të shqiptuar, do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahet nga këto veprime/kryerja e veprës-veprave penale të këtilla.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të tij e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 42 e lidhur me nenin 184 par.1 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptoi dënimin me burgim si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Forma bazë e kësaj vepre penale është e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 184 të KPRK-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*, andaj gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënim me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se kështu arrihet qëllimi i dënimit në drejtim të rehabilitimit të të pandehurit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 paragrafi 1 dhe 2, dhe nën paragrafi 2.6, nenit 450 dhe 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi lidhur me taksën për programin e kompensimit të viktimave, është marr konform nenit 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

I dëmtuari S.K, me vendbanim në rr. “.....“, Komuna e Pejës, gjatë shqyrtimit fillestar shprehimisht ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike, respektivisht nuk ka parashtruar një kërkesë të tillë, andaj mbi këtë arsye gjykata, e në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 458 dhe 460 të KPPRK-së, të dëmtuarin nuk e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.215/24, me datë 27.02.2025.**

**Zyrtarja ligjore**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

**Blerinda Laiq**

\_\_\_\_\_  
**Blerta KERMENDI**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e pakënaqur brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.